

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Mbikqyrje Riforcimi pallateve me kod Gis: 5407, 25387, 26969, 1511, 25947, 26972, 27307, 26764”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimit

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.97/2019 “Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e Ligjit,Nr.9,date 16.12.2019, te Keshillit te Ministrave, “Per perballimin e pasojave të fatkeqësise natyrore” , Vendimit Nr. 225, date 12.04.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar;

Për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte “Procedurë e përsheptuar – rindertimi shërbime”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përvec ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumenta.

Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4’738’477 (katër milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Afati i realizimit është 224 ditë

Afatet e ekzekutimit: Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjti me afatin e publikuar të realizimit të punimeve.

Argumentim:

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: “RIFORCIM I PALLATEVE ME KOD GIS 5407, 25387, 26969, 1511, 25947, 26972,27307, 26764.grupi i punës u bazua në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016.”, Seksioni II “NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE”

Mbështetur në tabelën 6 të Nenit 26, “Tabela shoqëruese e tarifave - NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE GRUPI TARIFOR III

Kostoja e llogaritshme e veprës (preventivi i punimeve) ka vlerë 417 302 520 lekë pa tvsh

Vlera maksimale e të gjithë shërbimit nga faza I-rë deri në të IX rezultoi:

$417\,302\,520 \times 3.66\% = 15,285,410.89$ lekë pa tvsh

Mbikqyrja zë 31 % për rikonstruksionin të vlerës sipas tabelës Nr. 3, Neni 24.

Vlera e mbikqyrjes për objektin e mësipërm është:

Vlera maksimale: $15,285,410.89 \times 31\% = 4,738,477$ lekë pa t.v.sh.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1'620'000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe mbeshtetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006, Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’620’000 lekë:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- **Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë** hartuar, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloraritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim te punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 – Punime gjermimi në tokë
- NP-2 – Ndertime civile dhe industriale
- NS-1 – Punime për prishjen e ndertimeve,
- NS-2 – Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavaneri, mirembajtja e tyre
- NS-3 -Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- NS-4 – Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- NS-14 – Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.759, datë 12.11.2014 “Për licensimin profesional të individëve dhe personave juridike, që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar.

Licensat e mësipërme kërkohen në bazë të zërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

Termet e referencës dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave të referencës, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi "Liria", Qyteti Durrës
Tel/Fax 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Faqja e Internetit www.durres.gov.al

2. **Lloji i procedurës së prokurimit:** Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit).

3. **Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** "Mbikqyrje Riforcimi pallateve me kod Gis: 5407, 25387, 26969, 1511, 25947, 26972, 27307, 26764".

4. **Numri i referencës së procedurës/lotit :** REF-35831-07-08-2022

5. **Fondi / vlera e përafërt e kontratës:** 4'738'477 (katër milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

6. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 224 ditë

7. **Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **22.07.2022** Ora: **10:00**
Vendi: Prokurim elektronik www.app.gov.al

8- **Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **22.07.2022** Ora: **10:00**
Vendi: Bashkia Durrës, Prokurim elektronik www.app.gov.al

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarëve të njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit